

### **Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropian (KKGJE)**

#### **Opinionin nr. 4 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropian në vëmendjen e Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës lidhur me trajnimin e duhur fillestar dhe në shërbim për gjyqtarët në nivel nacional dhe evropian.**

##### Hyrje

1. Në një kohë kur ne po jemi dëshmitarë të një ngritje të vëmendjes ndaj rolit dhe rëndësisë së gjyqësorit, i cili konsiderohet si garantues përfundimtar i funksionimit demokratik të institucioneve në nivelin nacional, evropian dhe ndërkombëtar, çështja e trajnimit të gjyqtarëve të ardhshëm para se ata të marrin pozitën e tyre dhe të trajnimit në shërbim është e një rëndësie të veçantë (shih Opinionin e KKGJE nr. 1 (2001), paragrafi 10-13 dhe Opinionin Nr. 3 (2002), paragrafët 25 dhe 50. ix).
2. Pavarësia e gjyqësorit u jep të drejta gjyqtarëve të të gjitha niveleve dhe juridiksioneve, por imponon detyra etike gjithashtu. Kjo e fundit përfshinë detyrën për të kryer punën gjyqësore profesionalisht dhe me përkushtim, që nënkupton se ata duhet të kenë shkathtësi profesionale, të përvetësuar, të mbajtura dhe të përforcuara me anë të trajnimit së cilit duhet t'i nënshtrohen si detyrë dhe si e drejtë e tyre.
3. Është qenësore që gjykatësit e përzgjedhur pasi t'i kenë përfunduar të gjitha studimet gjyqësore, të ndjekin edhe trajnimin e detajuar dhe të larmishëm në mënyrë që ata të jenë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre në nivelin e kënaqshëm.
4. Një trajnim i tillë është gjithashtu një garanci e pavarësisë dhe paanësisë së tyre në përputhshmëri me kërkesat e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.
5. Së fundi, trajnimi është një parakusht për vlerësimin e gjyqësorit dhe që ai ia vlen të respektohet. Besimi që qytetarët i falin sistemit gjyqësor do të fuqizohet nëse gjyqtarët posedojnë një njohuri të detajuar dhe të larmishme që shkon përtej fushës teknike të së drejtës tek fushat e brengës së rëndësishme sociale, si dhe tek gjykatorja dhe shkathtësitë personale dhe të të kuptuarit duke i'u mundësuar atyre menaxhimin e rasteve dhe trajtimin e duhur dhe me delikatesë të të gjithë personave të përfshirë. Me pak fjalë trajnimi është qenësor për objektivin, performancën e paanshme dhe kompetentë të funksioneve gjyqësore si dhe për të mbrojtur gjyqtarët nga ndikimet e papërshtatshme.
6. Ekzistojnë dallime të mëdha në mes të vendeve evropiane përkitazi trajnimit fillestar dhe atij në shërbim të gjyqtarëve. Këto dallime pjesërisht mund të jenë të ndërlidhura me veçoritë e veçanta të sistemeve të ndryshme gjyqësore, por në disa aspekte nuk duken të jenë të pashmangshme ose të nevojshme. Disa vende ofrojnë trajnime të gjata dhe formale në institucione të specializuara, pasuar nga një trajnim i mëtejshëm intensiv. Të tjerat vende ofrojnë një lloj praktike të mësimin nën mbikëqyrje të një gjyqtari me përvojë, i cili përçon njohurinë dhe këshillat profesionale në baza të shembujve konkret, duke treguar se çfarë qasje duhet të merret në mënyrë të që t'i shmangen çfarëdo lloji të didaktizmit. Vendet e së drejtës zakonore mbështetën shumë në përvojë të gjatë profesionale, zakonisht si avokatë. Në mesin e

e këtyre mundësive, ekziston një numër i vendeve ku trajnimi deri në një shkallë është i organizuar dhe i detyrueshëm.

7. Përkundër larmisë së sistemeve institucionale nacionale dhe probleme që dalin në vende të caktuara, trajnimi duhet të konsiderohet si qenësor në këndvështrim të nevojës për të përmirësuar jo vetëm shkathtësitë e atyre në shërbimin gjyqësor publik por gjithashtu vet funksionimin e atij shërbimi.

8. Rëndësia e trajnimit të gjyqtarëve është e njohur në instrumente ndërkombëtare si në Parimet Themelore të OKB-së mbi Pavarësinë e Gjyqësorit, miratuar në vitin 1985, ashtu edhe tekstet e Këshillit të Evropës miratuar në vitin 1994 (Rekomandimi Nr. R (94) 12 mbi pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve), në vitin 1998 (Karta Evropiane mbi Statutin e Gjyqtarëve) e cila i ishte referuar paragrafit 11 të Opinionit Nr. 1 të KKGJE.

#### I. E drejta për trajnim dhe niveli ligjor në të cilin kjo e drejtë duhet të garantohet

9. Parimet konstitucionale duhet të garantojnë pavarësinë dhe paanshmërinë prej të cilëve varet legjitimiteti i gjykatësve dhe gjykatësit në anën tjetër duhet të sigurojnë se posedojnë një shkallë të lartë të kompetencës profesionale (shih paragrafin 50 (ix) i Opinionit Nr. 3 të KKGJE).

10. Në shumë vende trajnimi i gjykatësve udhëhiqet nga rregullore speciale. Çështja kryesore është të përfshihet nevoja për trajnim me anë të rregullave që udhëheqin me statusin e gjyqtarëve; rregulloret ligjore nuk ofrojnë në detaje përmbajtjen e saktë të trajnimit, por ia besojnë këtë detyrë një organi special përgjegjës për përpilimin e plan-programit duke ofruar trajnim dhe mbikëqyrje të ofrimit të tij.

11. Shteti ka për detyrë që t'i ofroj gjyqësorit ose organit tjetër përgjegjës gjyqësor për organizimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit mjete të trajnimit, si dhe të paguaj kostot e shkaktuara nga gjykatësit dhe të tjerët të përfshirë.

12. Prandaj KKGJE rekomandon që, në çdo vend, legjislacioni mbi statusin e gjyqtarëve duhet të ofroj trajnim për gjyqtarët.

#### II. Autoriteti përgjegjës për trajnim

13. Në Kartën Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve (paragrafin 2.3) theksohet se çdo autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e cilësisë së programit të trajnimit duhet të jetë i pavarur nga Ekzekutivi dhe Legjislativi dhe së paku gjysma e anëtarëve të tij duhet të jenë gjyqtarë. Në Memorandumin Sqarues gjithashtu theksohet se trajnimi i gjyqtarëve nuk duhet të jetë i kufizuar me trajnim teknik ligjor, por duhet gjithashtu të merret parasysh se natyra e zyrës ligjore shpesh kërkon që gjyqtarët të intervenojnë në situata komplekse dhe të vështira.

14. Kjo thekson rëndësinë kyçe që i bashkëngjitet pavarësisë dhe përbërjes së autoritetit përgjegjës për trajnim dhe përmbajtjes së tij. Ky është rrjedhim logjik i parimit të përgjithshëm të pavarësisë gjyqësore.

15. Trajnimi është një çështje e interesit publik dhe duhet të ruhet pavarësia e autoritetit përgjegjës për përpilimin e plan-programit dhe vendosjes mbi atë se çfarë trajnimi duhet të ofrohet.

16. Gjyqësori duhet të luaj një rol të madh në ose vetë të jetë përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit. Në përputhje me rrethanat dhe rekomandimet e Kartës Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarë,

KKGJE avokon që këto përgjegjësi duhet që, në çdo vend, t'i besohen, jo Ministrisë së Drejtësisë apo ndonjë autoriteti tjetër përgjegjës ndaj Legjislativit ose Ekzekutivit, por vetë gjyqësorit apo ndonjë organi tjetër të pavarur (duke përfshirë Komisionin e Shërbimit Gjyqësor). Shoqatat e gjyqtarëve gjithashtu mund të luajnë një rol të vlefshëm në inkurajimin dhe në lehtësimin e trajnimit, duke punuar në bashkëpunim me gjyqësorin apo organin tjetër që ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë.

17. Në mënyrë që të sigurohet një ndarje e duhur e roleve, autoriteti i njëjtë nuk duhet të jetë drejtpërdrejtë përgjegjës si për trajnimin ashtu edhe për gjyqtarët disiplinues. Prandaj KKGJE rekomandon që, nën autoritetin e gjyqësorit apo ndonjë organi tjetër të pavarur, trajnimi duhet t'i besohet një institucioni të veçantë autonom me buxhet të vetin, i cili është në gjendje, që në konsultim me gjyqtarët, të pajisë programet e trajnimit si dhe të siguroj zbatimin e tyre.

18. Ata që janë përgjegjës për trajnim, nuk duhet që **drejtpërdrejt** të jenë përgjegjës për emërimin ose avancimin e gjykatësve. Nëse organi (p.sh komisioni i shërbimit gjyqësor) **referuar Opinionit Nr. 1 të KKGJE, paragrafët 73 (3), 37, dhe 45**, është kompetent për trajnim dhe emërim ose avancim, një ndarje e qartë duhet të ofrohet në mes të degëve përgjegjëse për këto detyra.

19. Në mënyrë që të mbrohet institucioni nga ndikimi jo i duhur i jashtëm, KKGJE rekomandon që stafi menaxherial dhe trajnuesit e institucionit duhet të emërohen nga gjyqësori ose organi i pavarur për organizimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit.

20. Është me rëndësi që trajnimi të mbahet nga gjykatës dhe ekspertë në çdo disiplinë. Trajnerët duhet të përzgjidhen nga më të mirët në profesionin e tyre si dhe të përzgjidhen me kujdes nga organi përgjegjës për trajnim, duke marr parasysh njohurinë e tyre të lëndëve që kanë mësuar dhe shkathhtësitë e tyre mësimdhënëse.

21. Kur gjyqtarët janë përgjegjës për aktivitetet e trajnimit, është me rëndësi që këta gjyqtarë të ruajnë kontaktin me praktikën gjyqësore.

22. Metodatat e trajnimit duhet të përcaktohen dhe rishikohen nga autoriteti trajnues dhe duhet të ketë takime të rregullta për trajnerët për t' ju mundësuar atyre të ndajnë përvojat e tyre si dhe të përmirësojnë qasjen e tyre.

### III. Trajnimi fillestar

#### a. A duhet të jetë trajnimi i detyrueshëm?

23. Përderisa është e dukshme që gjyqtarët të cilët janë rekrutuar në fillim të karrierës së tyre profesionale kanë nevojë të trajnohen, shtrohet pyetja se a është kjo e nevojshme kur gjyqtarët përzgjidhen nga mes i avokatëve më të mirë, e që kanë përvojë, si (për shembull) në vendet e së drejtës zakonore.

24. Në opinionin e KKGJE, që të dy grupet duhet të ndjekin trajnimin fillestar: performanca e detyrave gjyqësore është një profesion i ri për të dy grupet , dhe përfshinë një qasje të veçantë në shumë fusha, sidomos përkitazi etikës profesionale të gjyqtarëve, procedurës, dhe marrëdhënieve me të gjithë personat e përfshirë në procedura gjyqësore.

25. Në anën tjetër, është me rëndësi të merren parasysh veçoritë specifike të metodave të rekrutimit pra për të pasur në cak dhe adaptuar si duhet programet e trajnimit: avokatët me përvojë kanë nevojë të trajnohen vetëm për atë çfarë kërkohet në profesionin e tyre të ri. Në disa vende të vogla me një gjyqësor shumë të vogël, mundësitë e trajnimit lokal mund të jenë më të kufizuara dhe më informale, por vendet e tilla në veçanti mund të përfitojnë nga mundësitë e shkëmbyera të trajnimit me vendet e tjera.

26. Prandaj KKGJE rekomandon trajnim të detyrueshëm fillestar me programe të përshtatshme për përvojën profesionale të të emëruarve.

#### b. Programi fillestar i trajnimit

27. Plan-programi i trajnimit fillestar dhe intensiviteti i trajnimit do të dallojnë shumë sipas metodës së përzgjedhur për rekrutimin e gjyqtarëve. Trajnimi nuk duhet të përbëhet vetëm nga udhëzimi në teknika të përfshira në trajtimin e rasteve nga gjykatësit, por gjithashtu duhet të merr parasysh nevojën për ngritje të vetëdijes sociale dhe një kuptim më të gjerë të subjekteve të ndryshme që reflektojnë kompleksitetin e jetës në shoqëri. Për më tepër, hapja e kufijve nënkupton se gjyqtarët e ardhshëm kanë nevojë që të jenë në dijeni se ata janë gjyqtarë evropianë si dhe të jenë më shumë në dijeni për çështjet evropiane.

28. Nga këndvështrimi i shumëllojshmërisë së sistemeve për trajnimin e gjyqtarëve në Evropë, KKGJE rekomandon që:

i. të gjithë të emëruarit në poste gjyqësore duhet të kenë ose fitojnë, para se të marrin detyrat e tyre, njohuri të gjerë të ligjit substancial nacional dhe ndërkombëtar si dhe procedurës;

ii. programet e trajnimit të jenë më specifike, për të ushtruar profesionin e gjyqtarit kjo duhet të vendoset nga institucioni përgjegjës për trajnim, si dhe nga vetë trajnuesit dhe gjyqtarët;

iii. këto programe teorike dhe praktike nuk duhet të kufizohen me teknika në fushat krejtësisht ligjore por gjithashtu përfshinë trajnim në etikë dhe një hyrje në fushat tjera përkatëse të aktivitetit gjyqësor, siç është menaxhimi i rasteve dhe administrimi i gjykatave, teknologjia informative, gjuhët e huaja, shkencat sociale dhe zgjidhja alternative e kontestit (ZAK);

iv. trajnimi duhet të jetë pluralist në mënyrë që të garantohet fuqia dhe pikëpamjet e hapura të gjyqtarit;

v. varësisht nga ekzistenca dhe kohëzgjatja e përvojës paraprake profesionale, trajnimi duhet të jetë i kohëzgjatjes së konsiderueshme në mënyrë që t'i shmangemi asaj që të jetë krejtësisht çështje forme.

29. KKGJE rekomandon praktikën e ofrimit të periudhës së trajnimit të përbashkët të profesioneve të ndryshme ligjore dhe gjyqësore (për shembull, avokatët dhe prokurorët në ato vende ku kryejnë detyra të ndara nga ato të gjyqtarëve). Kjo praktikë ka gjasa që të nxis njohuri më të mirë dhe kuptim reciprok në mes gjyqtarëve dhe profesioneve të tjera.

30. KKGJE gjithashtu ka theksuar se shumë vende mund të kenë qasje në poste gjyqësore varësisht nga përvoja paraprake profesionale. Përderisa nuk duket të jetë e mundshme të imponohet një model i tillë në çdo vend, dhe përderisa adoptimi i sistemit që kombinon llojet e ndryshme të rekrutimit mund të ketë gjithashtu përparësinë e kualifikimeve të llojllojshme të gjykatësve, është me rëndësi që periudha e trajnimit fillestar të përfshijë, rastin e kandidatëve të cilët kanë ardhur drejt nga universiteti, periudhën substanciale të trajnimit në mjedis profesional (praktikat e avokatëve, kompanive, etj).

#### IV. Trajnimi në shërbim

31. Krejt ndaras nga njohuria elementare që ata duhet të kenë para se të marrin postet e tyre, gjyqtarët gjithashtu janë të dënuar me studim dhe mësim të përhershëm” (shih raportin e R. Jansen “Si të përgatiten gjyqtarët që të bëhen gjyqtarë të kualifikuar në vitin 2003”, dok. KKGJE – GT (2003)3).

32. Një trajnim i tillë është bërë i domosdoshëm jo vetëm me anë të ndryshimeve në ligj, teknologji dhe njohuri të kërkuar për të kryer detyrat gjyqësore por gjithashtu me anë të mundësisë në shumë vende që gjyqtarët të marrin përgjegjësi të reja kur të marrin postet e reja. Prandaj programet në shërbim duhet të ofrojnë mundësi të trajnimit në rast të ndryshimeve në karrierë siç është lëvizja nga gjykata penale në gjykatë civile; marrja e postit të specialistit të juridiksionit (p.sh në familje, në gjykatë për të mitur dhe atë sociale) si dhe marrja e postit në kryesinë e dhomës ose gjykatës. Një lëvizje e tillë ose marrja e një përgjegjësie të tillë mund të kushtëzohet me ndjekje të një programi përkatës të trajnimit.

33. Përderisa është qenësore që të organizohet trajnim në shërbim, meqenëse shoqëria ka të drejtën të përfitoj nga një gjyqtarë i trajnuar mirëfilli, është gjithashtu e nevojshme që të përhapet kultura e trajnimit në gjyqësor.

34. Nuk është reale që të bëhet trajnimi në shërbim i detyrueshëm në çdo rast. Frika është se pastaj mund të bëhet burokratike dhe thjeshtë një çështje forme. Trajnimi i sugjeruar duhet të jetë tërheqës sa duhet për t'i nxitë gjyqtarët që ta ndjekin atë, si pjesëmarrja në baza vullnetare është garancia më e mirë për efektivitetin e një trajnimit. Kjo gjithashtu duhet të lehtësohet duke siguruar që çdo gjyqtarë të jetë i vetëdijshëm se ekziston një detyrë etike për të ruajtur dhe azhurnuar njohurinë e tij ose saj.

35. KKGJE gjithashtu inkurajon në kontekst të bashkëpunimit të vazhdueshëm për trajnim me organet tjera ligjore profesionale dhe përgjegjëse për trajnim të vazhdueshëm në lidhje me interesat e përbashkëta (p.sh legjislacioni i ri).

36. Më tej theksohet dëshirueshmëria e aranzhimit të trajnimit të vazhdueshëm gjyqësor në atë mënyrë sa që të përfshijë të gjitha nivelet e gjyqësorit. Kurdo që është e realizueshme, nivelet e ndryshme duhet të gjitha të përfaqësohen në seancat e njëjta, duke ofruar mundësi për shkëmbim të këndvështrimeve në mes tyre. Kjo ndihmon në ndarjen e tendencave hierarkike, mbanë të gjitha nivelet e gjyqësorit të informuara për problemet dhe brengat e njëri tjetrit dhe avancojnë një qasje më të bashkuar dhe më të qëndrueshme në tërë gjyqësorin.

37. Prandaj KKGJE rekomandon që:

- i. trajnimi në shërbim duhet normalisht të jetë i bazuar në pjesëmarrje vullnetare të gjyqtarëve;

ii. trajnimi në shërbim mund të jetë i detyrueshëm vetëm në raste të veçanta; shembujt mund të (nëse ashtu vendos organi gjyqësor apo ndonjë tjetër organ përgjegjës) përfshijnë atë kur një gjykatës merr postin e ri apo fillon të kryej ndonjë lloj tjetër pune apo funksion apo në rastin e ndonjë ndryshimi thelbësor në legjislacion;

iii. programet e trajnimit duhet të përpilohen nën autoritetin e organit gjyqësor apo ndonjë organi tjetër përgjegjës për trajnim fillestar si dhe atë në shërbim nga vetë trajnerët dhe gjyqtarët;

iv. ato programe të zbatuara nën autoritetin e njëjtë, duhet të përqendrohen në çështje ligjore dhe të tjera lidhur me funksionet e kryera nga gjyqtarët dhe që i përputhen nevojave të tyre (shih paragrafin 27 më lartë);

v. gjykatat vetë duhet të inkurajojnë anëtarët e tyre të ndjekin kurset e trajnimit në shërbim;

vi. programet duhet të zhvillohen në dhe inkurajojnë një mjedis, në të cilin anëtarët e degëve dhe niveleve të ndryshme të gjyqësorit mund të takohen dhe shkëmbejnë përvojat e tyre si dhe të arrijnë njohurinë e përbashkët;

vii. përderisa trajnimi është një detyrë etike për gjyqtarë, vendet anëtare gjithashtu kanë për detyrë që t'iu vënë në funksion gjyqtarëve resurset financiare, kohën dhe mjetet tjera të nevojshme për trajnim në shërbim.

## V. Vlerësimi trajnimit

38. Në mënyrë që vazhdimisht të përmirësohet cilësia e trajnimit gjyqësor, organet përgjegjëse për trajnim duhet të kryejnë vlerësime të shpeshta të programeve dhe metodave. Një rol i rëndësishëm në këtë proces duhet të luhet përmes mendimeve të shprehura nga të gjithë pjesëmarrësit në iniciativa të trajnimit, që mund të inkurajohet përmes mjeteve të duhura (përgjigje ndaj pyetjeve, intervista).

39. Përderisa nuk ka dyshim që performanca e trajnuesve duhet të monitorohet, vlerësimi i performancës së pjesëmarrësve në iniciativat është më i dyshimtë. Trajnimi në shërbim i gjykatësve mund të jetë me të vërtetë i frytshëm nëse ndërveprimi i tyre i lirë nuk ndikohet nga marrja parasysh e karrierës.

40. Në vendet që trajnojnë gjyqtarë në fillim të karrierës së tyre profesionale, KKGJE merr parasysh vlerësimin që rezultatet e trajnimit fillestar të jenë të nevojshme në mënyrë që të sigurohen emërimet më të mira në gjyqësor. Për dallim nga vendet që kanë përzgjedhë gjyqtarë nga rangjet e ndryshme të avokatëve me përvojë, aplikohen metoda objektive të vlerësimit para emërimit, me trajnim që organizohet vetëm pasi kandidatët të jenë përzgjedhur, kështu që në ato vende vlerësimi gjatë trajnimit fillestar nuk është i duhur.

41. Sidoqoftë, është me rëndësi, nëse kandidatët i nënshtrohen vlerësimit, ata duhet t'i gëzojnë mekanizmat mbrojtës që i mbrojnë nga arbitrariteti në vlerësim të punës së tyre. Për më tepër, nëse shteti aranzhon emërimet e përkohshme të gjyqtarëve, heqja e tyre nga zyra në fund të trajnimit duhet të bëhet duke marr parasysh mekanizmat mbrojtës që aplikohen për gjyqtarë kur parashihet heqja e tyre nga zyra.

42. Sipas asaj që u tha më lartë, KKGJE rekomandon që:

- i. programet e trajnimit dhe metodat duhet t'i nënshtrohen vlerësimeve të shpeshta nga organet përgjegjëse për trajnim gjyqësor;
- ii. në parim, pjesëmarrja në iniciativat e trajnimit të gjyqtarëve nuk duhet t'i nënshtrohen vlerësimit cilësor; pjesëmarrja e tyre në vetvete, marrë në shqyrtim objektivisht, mund sidoqoftë të merret parasysht për vlerësim profesional të gjyqtarëve;
- iii. cilësia e performancës së trajnuesve duhet të vlerësohet, nëse vlerësimi i tillë është bërë i nevojshëm me faktin që në disa sisteme trajnimi fillestar është një fazë e procesit të rekrutimit.

#### VI. Trajnimi evropian i gjyqtarëve

43. Çfarëdo qoftë natyra e detyrave të tyre, asnjë gjyqtarë nuk mund të injoroj ligjin e evropian, qoftë ajo Konventa Evropiane për të Drejta të Njeriut apo Konventa tjera të Këshillit të Evropës, apo nëse është e nevojshme, Traktati i Bashkësisë Evropiane dhe legjislacioni që del nga ai, sepse nga ta kërkohet që ta aplikojnë drejtpërdrejt tek rastet që i kanë para veti.

44. Në mënyrë që të promovohet ky tipar i detyrave të gjyqtarëve, KKGJE konsideron se vendet anëtare, pas fuqizimit të studimit të ligjit evropian në universitete, duhet po ashtu të promovojnë përfshirjen e tij në programe të trajnimit fillestar dhe atij në shërbim propozuar për gjyqtarë, me referencë të veçantë të aplikimeve të tij në punët ditore.

45. Gjithashtu rekomandon fuqizimin e rrjetit evropian për shkëmbimin e informatave në mes të personave dhe subjekteve përgjegjëse për trajnim të gjyqtarëve (Rrejt i Lisbonës), që promovon trajnime për çështje të interesit të përbashkët dhe ligjit krahasues, dhe se ky trajnim duhet të shërbej për trajnuesit si dhe për vetë gjyqtarët. Funksionimi i këtij Rrjeti mund të jetë efikas vetëm nëse çdo vend anëtar e mbështetë atë, sidomos, duke themeluar një organ përgjegjës për trajnimin e gjyqtarëve, siç është përcaktuar në pjesën II më lartë, dhe me bashkëpunimin pan-Evropian në këtë fushë.

46. Për më tepër, KKGJE konsideron se bashkëpunimi brenda iniciativave që kanë për qëllim bashkimin e institucioneve për trajnim gjyqësor në Evropë, në veçanti brenda Rrjetit Evropian për Trajnim Gjyqësor, mund që me efikasitet t'i kontribuoj bashkërendimit më të madh dhe harmonizimit të programeve dhe metodave të trajnimit të gjyqtarëve në mbarë kontinentin.